



Elian Stefa është një kurator i pavarur dhe studiues i arkitekturës me qendër në Tiranë. Nga viti 2019 ai drejton [Galeria e Bregdetit](#), një hapësirë e pavarur buzë detit në jug të Shqipërisë, ndërsa vazhdon kërkimet e tij territoriale me [ARTILERIA Sazan](#).

EKOLOGJITË E SË ARDHMES

~ Ishulli i Gjembave ~

Kurator Elian Stefa

GALERIA e BREGDETIT

7 Korrik – 3 Gusht, 2021

“Ata e quajnë “Ishulli i Gjembave” për shkak të ligësisë së tij të perceptuar. Thuhet se kushdo që dëshiron të shkelë në brigjet e tij do t’u dëmtohet anija e tyre para se të mberrijnë diku afër tij. Pak e dinë se si e ka marrë atë emër ose kur, por akoma më pak përpiqen të depërtojnë në perimetrin e tij. Legjendat që rrethojnë ishullin përshkruajnë imazhe të një shoqërie vendasish të izoluar dhe të vetëmbajtur që janë të pamëshirshëm me ata që përpiqen të shkelin në tokat e tyre të nderuara. Dhe ndërsa këto histori mund të jenë thjesht fabula paralajmëruese, ajo që është përtej diskutimit është se ishulli është ashpërsisht i gjallë. Kodrat e gjelbërta duken të buta nga përtej gjirit dhe ndriçimi i qytetërimit mund të shihet që vezullon si një mirazh gjatë mbremjes. Thirrja e ishullit, si një sirenë, ose një oaz, fenerë çlirimi nga shkretëtira djerrë që kudo tjetër duket se është bërë. Dhe kështu, me tej ne vazhdojmë.”

- Fragment nga një ditar i gjetur; autor i panjohur; vit i panjohur

“Ishulli I Gjembave” është kontekstualizimi shqiptar i [EKOLOGJITË E SË ARDHMES](#), një program nga *WE ARE HERE: Artists’ Moving Image* nga British Council Collection dhe LUX. Spekulumimi mbi temat e eksploruara nga pesë artistë të MB-së në dialog me pesë artistë nga Shqipëria dhe Kosova, “Ishulli i Gjembave” punon drejt kontekstualizimit të EKLOGJITË E SË ARDHMES si një manifest për një transformim simbolik gjysmë-trillues, të ishullit të Sazanit, duke luajtur gjithashtu me mundësinë e përdorimit të trillimeve si mjet i dizajnit.

Manifesti bazohet në fragmente të historisë luftarake të ishullit si themele të një realiteti alternativ, ku ishulli i Sazanit është një nga bastionet e pakta të mbetura të jetës në planetin tokë. Ekspozita spekulon që veprat artistike të paraqitura janë objekte të mbijetuara nga ky univers paralel - relike të mbledhura që japin një vështrim të shkurtër në këtë dimension tjetër ku armiqtë imagjinarë detyruan një regjim totalitar paranojak të ndërtonte kështjella të bëra me rërë dhe legjenda të bëra prej ari. Utopitë dhe distopitë kanë aftësinë të uzurpohen dhe armatosen. A mund t'i përdorim më pas si një magji mbrojtëse?

Veprat e Uriel Orlow, Louis Henderson, Charlotte Prodger dhe Ben Rivers shoqërohen nga trilogjia e Driant Zeneli *Kur ëndrrat bëhen domosdoshmëri* me synimin e ripërcaktimit të idesë së dështimit, utopisë dhe ëndrrave si momente themelore për ndërtimin e alternativave të mundshme. Anna Ehrenstein përdor *Tools for Conviviality* për të sfiduar idenë utopike të teknologjive dixhitale si një mjet neutral. Bedwyr Williams heton psikedeliken dhe autentiken në lidhje me kozmosin, ndërsa Driton Selmani zbulon një mozaik nga një e ardhme primitive. Niku Alex Muçaj komenton mbi natyrën shumëplanëshe të trashëgimisë dhe Abi Shehu përpiket të kapë fantazmat nga e kaluara që ende diktojnë të tashmen tonë.

Isle of Thorns i kuruar nga Elian Stefa është pjesë e EKOLOGJITË E SË ARDHMES, një program nga *WE ARE HERE: Artists’ Moving Image* nga British Council Collection dhe LUX. i zhvilluar nga Tendai John Mutambu, British Council dhe LUX. EKOLOGJITË E SË ARDHMES në Ballkanin Perëndimor paraqiten përmes një programi ekspozitash, shfaqjesh dhe eventesh publike, të kuruar nga gjashtë kuratorë nga rajoni.